

VENDIM
Nr. 11, datë 16.2.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME MALIQ SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumen-tacionit mbështetës për miratimin e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Maliq sh.a., si më poshtë:

Njësitë administrative	Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse shërbimi	Tarifë aforfe	
				Për ujin e pijshëm	Për kanalizime
Maliq, Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirg (zona fushore)	a) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime	lekë/m³	lekë/muaj	lekë/muaj	lekë/muaj
	1. Konsumator familjar	45	54		50
	2. Konsumator publik	100	54		50
	3. Konsumator privat	105	54		50
	b) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime (pa matës)				
	1. Konsumator familjar		54	450	50
Maliq Libonik, Pirg, Gore, Moglicë (zona malore)	a) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime	lekë/m³	lekë/muaj	lekë/muaj	lekë/muaj
	1. Konsumator familjar	22.5	27		0
	2. Konsumator publik	100	54		0
	3. Konsumator privat	105	54		0
	b) Për shërbimin ujësjellës-kanalizime (pa matës)				
	1. Konsumator familjar		27	225	0

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 të jenë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Norma
Uji pa të ardhura	31%
Niveli i matjes	57%
Norma e arkëtimit	85%
Mbulimi me ujë	74%
Mbulimi me kanalizime	43%
Orët mesatare të furnizimit me ujë	13 orë
Staf për 1000 lidhje	8.6 punonjës

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Maliq sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani